



V E N D I M

K.P.P.742/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” & “Alb Shpresa” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-74001-06-07-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare – Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohovë 63.3 km*”, me fond limit 37 526 939 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

Ankimues:

BOE “Eral Construction Company” & “Alb Shpresa” shpk
Rruga e Kavajës , Pallati Nr.29, Kulla B, Ap.36, Kati 9 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër
Ish Zona Industriale Gjirokastër

Subjekt i Interesuar:

“Jody Company” shpk
Vlorë Finiq VRION, Zona Industriale pranë Kontrollit të automjeteve.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 07.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-74001-06-07-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare –*

Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohove 63.3 km”, me fond limit 37 526 939 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastr.

II.2. Në datën 12.07.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 06.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Eurostil	pa ofertë	I skualifikuar
- 2T	pa ofertë	I skualifikuar
- Adem Pojani	pa ofertë	I skualifikuar
- B-93	pa ofertë	I skualifikuar
- Eral Construction Company	25,405,720	I skualifikuar
- Jody Company	27, 733,000	I kualifikuar
- Beqiri	32 255 200	I skualifikuar
- Vagalat	33,484,202	I skualifikuar
- Cobial	35,673,200	I skualifikuar

II.4. Në datën 06.08.2018 BOE “Eral Construction Company” & “Alb Shpresa” shpk janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tyre në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik Eral Construction Company shpk & Alb Shpresa, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

- Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerese me subjektin GE & CO shpk, nenshkruar me date 05.07.2018, me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targe TR4893L, i eshte dhene me qera dhe dy subjekteve te tjera 2 T shpk dhe Sterkaj shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben fiktive dhe te pavlefshme kete kontrate.

- Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetet teknike “grejder”, në pronësi ose me qira, cope 1 dhe “asfaltoshtruese” në pronësi ose me qira, cope 1 operatori ekonomik Eral Konstruksion shpk ka paraqitur kontraten e qerese date 05.07.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Po keto mjete me anen e kontrates se qerese date 27.04.2018, i jane dhene subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe ose qe perfshin kete, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

- Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Caushi shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 06.06.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Eral Konstruksion shpk”, rezulton qe subjekti “Feba shpk”, date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

- Operatori Ekonomik nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3, te kriterëve te dhena ne lidhje me detyrime te pashlyra te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2017. Ai nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ne Libohove, ku dhe ka pasur aktivitet.

- Operatori Ekonomik nuk ka permbushur sic duhet piken 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar per periudhen (01 maj 2017 – 30 prill 2018), ne kompanine e tij minimalisht: 1 (një) Inxhinier Gjeodet, të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV.

II.5. Në datën 10.08.2018, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në lidhje me pretendimin tuaj për kontratën e qerasë të nënshkruar me qeradhënësin Ge-Co shpk me Nr.444 Rep Nr.194 Kol datë 05.07.2018 për makinerinë lloji Autobitumatrice, autoriteti duhet të shikojë më me vëmendje shtojcën e makinerive dhe njëkohësisht dokumentat e paraqitura sepse shoqëria jonë ka vendosur Autobitumatrice me targë TR 6291 R makineri kjo e pa dhënë me qera tek ndonjë subjekt fizik apo juridik dhe jo makinerinë me targë TR 4893 L sic pretendoni ju. AK duhet të jetë më i saktë në vlerësimet që ai jep sepse ne si operator ekonomik kemi plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dst dhe gjithashtu kriterin që makineritë të jenë të angazhuara vetëm në kontratën që do të marrin pjesë (bashkëngjitur dokumentat e makinerisë Tip Autobitumatrice, shtojca e makinerive dhe kontrata e qerasë).
- Në lidhje me pretendimin tuaj për kontratën e qerasë të nënshkruar me qeradhënësin Feba shpk me Nr.446 Rep Nr.195 Kol datë 05.07.2018 për makineri Grejder, fabrikë asfaltbetoni dhe asfaltoshruese duam tu bëjmë me dije që cdo lloj kontrate e bërë përpara ose mbas kësaj datë është e pavlefshme sepse vetë qeradhënësi i këtyre mjeteve me vërditje të plotë ka bërë nënshkrimin e kësaj kontrate duke pranuar para noterit që mjetet e dhëna nuk janë të dhëna në persona të tjerë juridikë /fizikë pikë kjo e cituar në kontratë tek afati i kontratës. Kontrata që ne kemi lidhur me këtë subjekt është vazhdim i rilidhjeve të kontratave që ne kemi bërë me shoqërinë Feba shpk fakti që është e vitit 2018 do të thotë që është në përputhje me kriteret e DST të cilat kërkonin që kontrata e qerasë të jetë e nënshkruar në vitin 2018 . Theksojmë që kontrata noteriale e qerasë është për një periudhë 3 vjecare dhe për më tepër në hartimin e saj cilësohet mos dhënia me qera në subjekte të tjerë juridike/fizik. Cdo lloj kontrate (qoftë qeraje/furnizimi) e bërë përpara ose mbas kësaj date është jo ligjore për arsye se nuk ka një revokim kontrate me mirëkuptimin e të dy palëve sic shprehet në kontratë që ne kemi paraqitur dhe autoriteti me të drejtë do të bënte skualifikimin e shoqërisë sonë. Të drejtën e revokimit të kontratës noteriale qeradhënëse midis Feba shpk dhe Eral Construction Company e ka mirëkuptimi midis dy palëve ose në të kundërt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në lidhje me pretendimin se shoqëria jonë nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e

Qeverisjes Vendore në Libohovë ku dhe ka pasur aktivitet. Theksojmë se shoqëria jonë ushtron aktivitet në vendet sipas viteve përkatëse:

Tiranë Viti 2017,2018

Vorë Viti 2017,2018

Gjirokastër Viti 2017

Tepelenë Viti 2017,2018

Pra shoqëria jonë për vendet në të cilat ka ushtruar aktivitetin i ka paguar të gjitha taksat duke u pajisur me vërtetim nga institucionet përkatëse. Në lidhje me taksat e libohovës ju bëjmë me dije se shoqëria jonë thjesht ka kryer mirëmbajtjen e rrugës dhe nuk ka ndërtuar një kantier në të cilën të furnizohet me ujë, të ketë energji elektrike , të ketë një sipërfaqe e mjaftueshme në të cilën për atë pjesë që shfrytëzon të paguajë të gjitha detyrimet për të cilat ndihet përgjegjëse. Fakti që nuk kemi qenë rezidentë por thjesht kemi kryer mirëmbajtjen e rrugës me të gjitha kushtet e nevojshme nuk do të thotë që kësaj bashkie ne i detyrohemi taksat rrugore. Arsyeja që pretendoni është totalisht në kundërshtim me kriteret e DST. Shoqëria jonë nuk i detyrohet as një bashkie ose komune në lidhje me taksat dhe detyrimet që ato përmbajnë.

- *Në lidhje me pretendimin tuaj se OE nuk ka përmbushur si duhet pikën 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar për periudhën 01 maj 2017-30 prill 2018 në kompaninë e tij minimalisht 1 ing gjeodet të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune , CV duam tju theksojmë se autoriteti sërish duhet të jetë më i vëmëndshëm në kontrollin e dokumentacionit që operatori ekonomik ka marrë pjesë në tender. Në rastin konkret në faqen Ëeb të spe tek dokumentat e fakteve ne kemi pasqyruar pdf me emërtimin 2 Alb Shpresa Stafi. Në brendësi të saj ndodhet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ing. Gjeodet Zylfi Gashi (shoqëruar me diplomë, librezë pune, kontratë pune e lidhur më datë 04.04.2016 (e cila përfshin të gjithë periudhën e kërkuar nga AK në harkun kohor 01 maj 2017-30 prill 2018. Për sa më lart arsyeja e skualifikimit bie në kundërshtim me dokumentat e paraqitura nga BOE. Bashkimi i operatorëve zotëron Gjeodet në të gjithë periudhën e kërkuar nga AK.*

Për sa më lart kërkojmë rikualifikimin e shoqërisë sonë pasi jemi në përputhje të plotë me kërkesat e DST dhe njëkohësisht duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit që është cmimi më i ulët.

II.6. Në datën 15.08.2018 me shkresën nr. 554 prot bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Eral Construction Company” shpk & “Alb Shpresa”, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 24.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 613 prot datë 04.09.2018 protokolluar me tonën me nr.1434/2 datë 10.09.2018 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Eral Construction Company” sh.p.k & “Alb Shpresa” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “*Operatori Ekonomik nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3, te kriterëve te dhena ne lidhje me detyrime te pashlyra te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2017. Ai nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ne Libohove, ku dhe ka pasur aktivitet.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k & “Alb Shpresa” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr. 260 Rep, Nr.206 Kol datë 11.07.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “*Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare – Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohove 63.3 km*”

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria Eral Construction Company” shpk merr përsipër të kryejë 93.7 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara me TVSH , shoqëria Alb Shpresa shpk merr përsipër në masën 6.3% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara me tvsh dhe po në këto raporte do të bëhet dhe shpërndarja e fitimit të përfituar midis palëve kontraktuese. Bashkëlidhur ndarja e puimeve sipas zërave të preventivit[...]”

Referuar preventivit të ndarjes së punimeve ndërmjet anëtarëve të bashkimit të operatorëve rezulton se Eral Construction Company shpk dhe Alb Shpresa shpk do të realizojnë së bashku në masën 85% Eral Construction Company dhe 15 % Alb Shpresa shpk zërat si më poshtë:

- Pastrim i kanaleve anësore të kullimit
- Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet sedimente apo bimët dhe prurjet e ngurta të depozituara.

- Nivelim i bankinave dhe mbushjeve ne nivelin fillestar
- Prerja, shkulja dhe pastrimi i bimësisë së rritur në zonën e rrugës
- Pastrimi i karazhatës nga aluvionet.
- Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit të papërgatitur në gropat e përgatitura
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e makadamit të lidhur me ujë të aprovuar për të krijuar shtresën bazë të rrugës
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e zhavorit/granilit për të riparuar karaxhatën dhe bankinat
- Eral Construction Company do të realizojë 100 % të zërave si mëposhtë:
 - Struktura monolite betoni C 16/20
 - Riparime me mur guri me ll.cim M25
 - Gabiona me rrjt teli të zinguar, gur kave 1x2x2
 - F.V Tabela të ndryshme rrugore D=60cm
 - F.V Tabela rrugore treguese 150x40 cm
 - F.V Guardrail N2 anësor me valëz E3 +aksesorët 50%
 - Vijëzim rruge me bojë biokomponent spraj
 - Përvijues anësor normal
 - Shtresë asfaltobetoni 4 cm me granil gurë kave memakeri (mesatar) në vlerën 552,695
 - Mirëmbajtje Dimërore

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.2.3 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.3 Operatori Ekonomik nuk duhet kete detyrime te pashlyra te taksave dhe tarifave vendore per vitin 2017.

Per kete duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet per vitin 2017.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se anëtari i bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt të regjistrimit tregëtar nga ku rezulton se selia qendrore e shoqërisë është në Tepelenë ndërsa ka vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit konkretisht në Vorë dhe në Tiranë. Në 11.06.2015 është shtuar adresa në Gjirokastër dhe është hequr më datë 29.12.2017.
- Vërtetim Nr.134794/1 datë 22.06.2017 “Për likuidimin e detyrimeve vendore” për vitin 2017 lëshuar nga Bashkia Tiranë

- Vërtetim Nr.468 prot datë 22.06.2018 lëshuar nga Bashkia Gjirokastrë me anë të së cilës vërtetohet se “Eral Construction Company” shpk ka shlyer detyrimet përkatëse për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.ska prot datë 25.06.2018 lëshuar nga Bashkia Tepelenë me anë të së cilës vërtetohet se “Eral Construction Company” shpk ka paguar detyrimet finaciare ndaj Bashkisë Tepelenë për vitin 2017.
- Vërtetim nr.200 prot datë 25.06.2018 lëshuar nga Bashkia Vorë me anë të së cilës vërtetohet se Eral Construction Company shpk nuk ka detyrime fiskale të papaguara ndaj Bashkisë Vorë për vitin 2017.
- Vërtetim Nr.116177/1 prot datë 24.04.2018 lëshuar nga Bashkia Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se Eral Construction Company shpk ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2018.
- Vërtetim Nr.129 prot datë 26.04.2018 lëshuar nga Bashkia Vorë me anë të së cilës vërtetohet se Eral Construction Company shpk ka paguar detyrimet fiskale ndaj Bashkisë Vorë për vitin 2018.
- Vërtetim Nr.ska prot datë 26.04.2018 lëshuar nga Bashkia Tepelenë me anë të së cilës vërtetohet se “Eral Construction Company” shpk ka paguar detyrimet finaciare ndaj Bashkisë Tepelenë për vitin 2018.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*

III.1.5. Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit sa më sipër, si dhe verifikimit të të dhënave të subjektit në Ekstraktin Historik të QKR konstaton se zyra qendrore e shoqërisë “Eral Construction Company” sh.p.k është në Tepelenë ndërsa në seksionin 14 “Vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit” të Ekstraktit Historik të QKR rezulton se operatori ekonomik ankimues ushtron aktivitetet përkatësisht në Vorë dhe në Tiranë.

Akoma më tej Komisioni verifikoi të gjitha ndryshimet në të dhënat e regjistruara të pasqyruara në mënyrë kronologjike në Ekstraktin Historik të subjektit “Eral Construction Company” sh.p.k dhe konstatoi se në 11.06.2015 është shtuar një adresë e re në Gjirokastrë dhe është hequr më datë 29.12.2017.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Eral Construction Company shpk për përmbushjen e kriterit *një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2017*, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik “Eral Construction Company shpk ka paraqitur vrëretimet përkatëse nga administrata vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit për vitin 2017 dhe 2018 nga ku rezulton se nuk ka detyrime të pashlyera, në përputhje të plotë me kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Lidhur me arsyen e skualifikimit se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore në Libohovë, ku dhe ka pasur aktivitet, KPP e gjen të pabazuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi e konkretisht ekstraktit të regjistrimit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nëpërmjet të cilit bëhet verifikimi i vendeve të ushtrimit të aktivitetit të subjekteve, konstaton se operatori ekonomik Eral Construction Company shpk nuk ka ushtruar aktivitet në Libohovë e rrjedhimisht nuk ka pasur asnjë detyrim për t ë paguar taksa dhe tarifa vendore në këtë njësi të qeverisjes vendore.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Eral Construction Company” sh.p.k & “Alb Shpresa” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se *“Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur sic duhet piken 2.3.3, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar për periudhën (01 maj 2017 – 30 prill 2018), në kompaninë e tij minimalisht: 1 (një) Inxhinier Gjeodet, të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Operatorët ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k & “Alb Shpresa” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr. 260 Rep, Nr.206 Kol datë 11.07.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit *“Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare – Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohovë 63.3 km”*

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Shoqëria Eral Construction Company” shpk merr përsipër të kryejë 93.7 % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara me TVSH , shoqëria Alb Shpresa shpk merr përsipër në masën 6.3% të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara me tvsh dhe po në këto raporte do të bëhet dhe shpërndarja e fitimit të përfituar midis palëve kontraktuese. Bashkëlidhur ndarja e puimeve sipas zërave të preventivit[...]

Referuar preventivit të ndarjes së punimeve ndërmjet anëtarëve të bashkimit të operatorëve rezulton se Eral Construction Company shpk dhe Alb Shpresa shpk do të realizojnë së bashku në masën 85% Eral Construction Company dhe 15 % Alb Shpresa shpk zërat si më poshtë:

- Pastrim i kanaleve anësore të kullimit
- Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet sedimente apo bimët dhe prurjet e ngurta të depozituara.
- Nivelim i bankinave dhe mbushjeve në nivelin fillestar
- Prerja, shkujla dhe pastrimi i bimësisë së rritur në zonën e rrugës
- Pastrimi i karazhatës nga aluvionet.
- Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit të papërgatitur në gropat e përgatitura
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e makadamit të lidhur me ujë të aprovuar për të krijuar shtresën bazë të rrugës
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e zhavorit/granilit për të riparuar karaxhatën dhe bankinat
- Eral Construction Company do të realizojë 100 % të zërave si mëposhtë:
 - Struktura monolite betoni C 16/20
 - Riparime me mur guri me ll.cim M25
 - Gabiona me rrjet teli të zinguar, gur kave 1x2x2
 - F.V Tabela të ndryshme rrugore D=60cm
 - F.V Tabela rrugore treguese 150x40 cm
 - F.V Guardrail N2 anësor me valëz E3 +aksesorët 50%
 - Vijëzim rruge me bojë biokomponent spray
 - Përvijues anësor normal
 - Shtresë asfaltobetoni 4 cm me granil gurë kave memakeri (mesatar) në vlerën 552,695
 - Mirëmbajtje Dimërore

III.2.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt.

Per këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar për periudhën (01 maj 2017 – 30 prill 2018), në kompaninë e tij minimalisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Eral Construction Company” shpk

- Kontratë Pune Nr. 402 rep nr.167 Kol datë 23.06.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë “Eral Construction Company” shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Entikel Lame në cilësinë e punëmarrësit me profesion Inxhinier Topograf (si drejtues Teknik)
- Diplomë Master i Shkencave lëshuar nga UPT në Gjeodezi i E.L
- Diplomë e Nivelit të parë në Inxhinieri Gjeodezi lëshuar nga UPT i E.L
- CV
- Librezë Pune

“Alb Shpresa” shpk

- Kontratë Pune Nr.1058 Rep Nr.400 Kol datë 04.04.2016 lidhur ndërmjet shoqërisë Alb Shpresa shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Zylfi Gashi në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Drejtues Teknike Inxhinier Markshajder Topograf shoqëruar me Diplomë lëshuar nga UPT me titull Inxhinier Miniere, Markshajder, Licencë në zbatim për punime topografike, topogjeodezike në objekte inxhinierike, CV, Librezë Pune

III.2.4. Në Kreun VIII (*“Kushte të përgjithshme për zbatim”*), neni 74 (*“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : *“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....*

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.2.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*

III.2.6. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.7. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që kanë të regjistruar në kompaninë e tyre për periudhën 1 maj 2017 deri në 30 prill 2018 minimalisht një inxhinier gjeodet, për vërtetimin e të cilit duhet të paraqesin dokumentacionin si diplomë, kontratë pune dhe CV.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes në përmbushje të kriterit të sipërcituar në të cilin kërkohet vetëm një inxhinier gjeodet shoqëruar me diplomë, kontratë pune dhe CV, rezulton se secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ka dëshmuar se disponon në stafin e tij inxhinier gjeodet.

Konkretisht operatori ekonomik “Eral Construction Company” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka dorëzuar kontratë pune të lidhur me punonjësin E.L. me profesionin inxhinier topograf (drejtues teknik), shoqëruar me diplomë, CV dhe librezë pune, duke vërtetuar kështu faktin që është

punonjës i kësaj shoqërie. Për më tepër, konstatohet se edhe anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë, operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriterin e kualifikimit (kontratë pune, cv, diplomë), duke vërtetuar disponimin në stafin e tij të një inxhinieri gjeodet.

Në kushtet kur jemi përpara një bashkimi operatorësh dhe kapacitetet teknike përmbushen në përputhje me përqindjen dhe zërat konkrete të marrë përsipër si dhe në kushtet kur në kriterin e kualifikimit kërkohet vetëm një inxhinier gjeodet, KPP gjykon se ky kriter plotësohet dhe tejkalohet nga të dy anëtarët e bashkimi duke dëshmuar se disponojnë (secili prej anëtarëve të këtij bashkimi) kapacitetet e nevojshme profesionale për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Referuar sa mësipër, duke parë dhe vlerësuar në tërësi kriterin në lidhje me kërkesën për inxhinierin gjeodet dhe dokumentacionin që duhet të paraqitet në lidhje me të, KPP gjykon se, e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që të jepet garanci që operatori ekonomik ka në shoqërinë e tij një inxhinier gjeodet, në mënyrë që të krijojë siguri për realizimin në kohë e me sukses të kontratës. Konkretisht, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme të vërtetohet se operatori ekonomik disponon në stafin e tij një inxhinier gjeodet gjë e cila është vërtetuar më së miri nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur.

Gjithashtu KPP referuar përqindjes së marrë përsipër, si edhe zërave konkretë të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, për ato zëra punimesh të marra përsipër, në kushtet kur është kërkuar një inxhinier gjeodet, rezulton se, ky kriter nga këta operatorë ekonomikë duhet të plotësohet në një masë të papërfillshme dhe të pallogaritshme duke mos plotësuar një shifër të numërueshme, çka rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet edhe për nga ana matematikore një numër i plotë, ndërkohë që nga ana e të dy operatorëve ekonomikë në proporcion me përqindjen e marrë përsipër, zërat e punës referuar preventivit, është paraqitur në mënyrë të plotë i gjithë dokumentacionin për personelin teknik, në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Eral Construction Company” sh.p.k & “Alb Shpresa” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se . *Bashkimi i Operatoreve ekonomik Eral Construction Company shpk & Alb Shpresa, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:*

- Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerase me subjektin GE & CO shpk, nenshkruar me date 05.07.2018, me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targe TR4893L, i eshte dhene me qera dhe dy subjekteve te tjera 2 T

shpk dhe Sterkaj shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben fiktive dhe te pavlefshme kete kontrate.

- Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetet teknike “grejder”, në pronësi ose me qira, cope 1 dhe “asfaltoshtruese” në pronësi ose me qira, cope 1 operatori ekonomik Eral Konstruksion shpk ka paraqitur kontraten e qerese date 05.07.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Po keto mjete me anen e kontrates se qerese date 27.04.2018, i jane dhene subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe ose qe perfshin kete, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

- Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Caushi shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 06.06.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Eral Konstruksion shpk”, rezulton qe subjekti “Feba shpk”, date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.7 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul vibruës	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavatore fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Mjete borepastrues	në pronësi ose me qira	Cope 1
9	Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / cdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të perkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatese.
- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerash, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.
- Për sa u përket mjetve borepastruese duhet të jenë të paisura me kripore dhe thika (ku të komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo të jenë të improvizuara si mjete borepastruese duke bërë bashkim pjesësh për të improvizuar borepastruese). Për mjetet borepastruese në lejet e qarkullimit të tyre duhet të jete e cilesuar si APV (automjet i përdorimit të vecantë). Mjetet borepastruese duhet të shoqërohen minimalisht me nga dy foto ku të dallohen qartësisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerash, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerash duhet të jenë të nënshkruara jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe të deklarojnë qartësisht nga qeradhënsi që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë.

Fabrika asfaltbetoni duhet të jete e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendndodhje jo më larg se 60 km nga objekti (mjafton nga një pikë e rrugëve që mëmbahen nga Kontrata). Ajo duhet të jete e pajisur me QKL dhe leje mjedisore. Ofertuesi duhet të deklarojë vendndodhjen e saktë të fabrikës së asfaltbetonit të montuar (nuk pranohet deklarate levizje impianti), të paraqesë planin e vendosjes të fabrikës së asfaltbetonit dhe të paraqesë fotografi të fabrikës së asfaltbetonit të montuar në vendndodhjen e deklaruar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontratë të tjera. Për këtë të paraqitet një deklarate nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontratë të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

III.3.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ishte:

Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të jenë të nenshkrura jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”

Bëhet:

“Kur mjetet/pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatohet se nga ana e operatorit ekonomik “Eral Construction Company” është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Shtojcë Mbi disponimin e makinerive, ku deklarohet, ndër të tjera, si më poshtë:
 - Grejder, tipi Aveling Bareford ASG 13, fletë doganore R 19909 viti 1990 i deklaruar me qera nga shoqëria Feba shpk me Nr.446 Rep Nr.195 Kol me afat 05.07.2018-05.07-2021
 - Asfaltoshtuese, tipi Ditelli , fletë doganore R 9046 datë 18.06.2005 , viti 1992, i deklaruar me qera nga shoqëria Feba shpk me Nr.446 Rep Nr.195 Kol me afat 05.07.2018-05.07-2021
 - Autobitumatrice me targë TR6291R, e deklaruar me qera nga shoqëria “Geco” sh.p.k. me nr. 444 rep, nr. 194 kol, afat 05.07.2018-05.07.2021;
 - Fabrikë asfaltobetoni, e deklaruar me fletë doganore, me qera nga shoqëria “Feba” sh.p.k. me nr. 446 rep, nr. 195 kol, me afat 05.07.2018 – 05.07.2021;
2. Kontratë qeraje Nr.446 Rep Nr.195 Kol datë 05.07.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë “Feba” sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt “[...] fabrikë asfaltobetoni, të fraksionit të inerteve dhe makinerinë e thërrmimit të gurit (gurëthyes) të shoqëruara me leje mjedisore “Për linjë e fraksionimit të inerteve, linjë e prodhimit të asfaltobetonit”, kodi III.I.B, lëshuar nga QKL me vendndodhje Luzat Tepelenë, të cilat ja jep me qera shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. me të dhënat e mëposhtme:
[...] fabrikë asfaltobetoni- lloji pjesë për impiantin Asfalti, fletë doganore R22014 dt.23.11.2006, targa AA413DD; cisternë bitumi (pjesë të linjës së asfaltobetonit) fletë doganore R 23390 Dt. 12.12.2006; bunker inerti 3 C (pjesë të linjës së asfaltit, fletë doganore R 23389 Dt 12.12.2006; pjesë për impiant Asfaltobeton (F.In, fletë doganore R 22640 t. 03.12.2006; pjesë linje asfalti (transportier + esikator) fletë doganore R 23104 Dt. 09.12.2006; pjesë të linjës së asfaltit (cisternë bitumi), fletë doganore R 23105, dt. 09.12.2006; pjesë, pajisje mekanike (pjesë për impiant asfalti) fletë doganore R 22012 Dt. 23.11.2006; makineri për thërrmimin e gurit fletë doganore R 19547, dt 13.12.2010; faturë me materialet totale të fabrikës nr.6 , dt. 27.11.2006 (impiant për asfalt, cisternë bitumi, filter këmishe, shkallë spirale, dhoma tharje,

kullë përzierëse, mbidozues 3 ndarëse, 2 ndarëse, tubacion aspirimi, tubacion bitumi, shirita transportues, gabinë me impiant elektrik, cisterna vajdjegëse, gjenerator 250 kë, silos për ngarkim, saldaturë me fije).

2. Grejder me fletë doganore R 19909 datë 19.03.2009 viti i prodhimit 1990, tipi Aveling Bareford ASG13, 3. Asfaltoshtruese me fletë doganore R 9046, dtaë 18.06.2005, viti i prodhimit 1992, tipi Ditelli 8850.

Në nenin "Afati i Kontratës" është përcaktuar: "Afati i kontratës do të jetë për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga data 05.07.2018 – 05.07.2021. Qeramarrësi ka të drejtë të bëjë zgjatje të afatit të kontratës nëse do të jetë e nevojshme. Qeradhënësi garanton që këto mjete dhe fabrika që i jep me qera janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik/invidid".

Në nenin "Detyrimet e qeradhënësit" përcaktohet: "Ta garantojë qiramarrësin nga cdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte".

-dokumentacioni përkatës

3. Kontratë qeraje Nr. 444 Rep Nr. 194 Kol datë 05.07.2018 e lidhur ndërmjet shoqërisë "Ge:Co" sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt "[...] jep me qera shoqërisë "Eral Konstruksion Company" shpk me të dhënat e mëposhtme: autobitumatrice – Targa TR4893L, lloji ATV Fiat,[...], autobitumatrice – Targa TR 6291R, lloji ATV Fiat [...].

Në nenin "Afati i Kontratës" është përcaktuar: "Afati i kontratës do të jetë për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga data 05.07.2018 – 05.07.2021. Qeramarrësi ka të drejtë të bëjë zgjatje të afatit të kontratës nëse do të jetë e nevojshme. Qeradhënësi garanton që këto mjete janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik".

Në nenin "Detyrimet e qeradhënësit" përcaktohet: "Ta garantojë qiramarrësin nga cdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte".

- dokumentacioni përkatës.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

III.3.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. & “Albshpresa” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka paraqitur dokumentacionin përkatës në lidhje me makineritë dhe mjetet që duhen për realizimin e kontratës.

Konkretisht, referuar arsyes së skualifikimit, të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur shtojcën përkatëse për disponimin e mjeteve, ku si më sipër përshkruar, janë deklaruar mjetet që do të vihen në dispozicion në lidhje me këtë procedurë prokurimi, duke u deklaruar lloji i mjetit, mënyra e disponimit (pronësi/qera), si edhe të dhënat e tjera përkatëse, të cilat përputhen secila, sipas deklarimit në këtë shtojcë, me dokumentacionin shoqërues të hedhur në sistemin e prokurimeve elektronike, sipas kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu, në këtë shtojcë, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është bërë deklarimi se (citojmë): *“Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë”*.

III.3.7. Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit të paraqitur në lidhje me këto mjete dhe konkretisht kontratave të qerave të lidhura ndërmjet operatorit ekonomik “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. dhe shoqërive qeradhënëse si më sipër cituar, konstatohet se, në të gjitha kontratat e qerasë (të renditura në pikën III.3.3.), janë të përcaktuara qartësisht të gjithë elementët dhe të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, në dokumentat e tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar në mënyrë eksplicite që *“[...] Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe të deklarohet qartësisht nga qeradhënsi që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë”*, kriter ky i plotësuar më së miri nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pasi në të gjitha kontratat e sipërcituara është deklaruar se (citojmë): *“Qeradhënësi garanton që këto mjete janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik/individ”*.

Gjithashtu, në këto kontrata është deklaruar në nenin “Detyrimet e qeradhënësit”: *“Ta garantojë qiramarrësin nga çdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte”*.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, thjesht e vetëm fakti i evidentuar nga autoriteti kontraktor se ky operator ekonomik ka lidhur kontrata qeraje për të njëjtat mjete me të njëjtat shoqëri në cilësinë e qeradhënësit, të cilët (këta të fundit) kanë lidhur kontrata qeraje me operatorë të tjerë ekonomikë “Stërkaj” sh.p.k., “2 T” sh.p.k., “Çaushi” sh.p.k., është një argument që nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë dhe tjetërsojë kontratat e lidhura mes shoqërive qeradhënëse dhe shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k., e aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi, ndërkohë që faktikisht referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga vetë autoriteti kontraktor, ky i fundit disponon kontratat e qerasë për mjetet, të cilat përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk mund të paragjykojë kontratat e qerasë të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, përse kohë që ato garantojnë me vullnet të lirë të të dy palëve, që mjetet e dhëna me qera nuk i janë dhënë askujt tjetër, e madje shkojnë edhe më tej, duke garantuar edhe faktin se, do shqetësim që mund ti vijë qeramarrësit (në rastin konkret shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k.) nga persona të tretë për probleme pronësie, probleme këto të cilat do të zgjidhen nga po vetë qeradhënësi, duke garantuar kështu autoritetin kontraktor në lidhje me disponimin në mënyrë të rregullt të gjitha mjeteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky i vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion (kontrata e qerasë) është lidhur me shprehje të vullnetit të lirë të dy shoqërive nënshkruese të kontratës e për më tej, duke u dhënë të gjitha garancitë e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nga ana e shoqërisë qeradhënëse, pasi në këtë kontratë përmbahen të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter, duke siguruar një panoramë të plotë në lidhje me mjetet dhe pajisjet.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me

dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-74001-06-07-2018 me objekt “Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Ura e Leklit – Kelcyre + rruga Kelcyre – Permet + rruga Valare – Erind – Cajup + rruga K/Dhuvjan – Libohovë 63.3 km”, me fond limit 37 526 939 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1434 Protokolli; Datë 24.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha